

ISLAMI

FEJA MË E VJETËR DHE MË E RE

Kur flitet për Islamin, zakonisht mendohet për Shpalljen e fundit dhe të dërguarin e fundit nga All-llahu xh. sh., Muhamedin a.s. Të paktë janë ata njerëz që e kanë të njohur faktin se Islami është feja e parë, se ekziston prej kur ekziston njeriu i parë në faqen e Tokës, e ndoshta në mesin e atyre që nuk e dinë këtë, ka edhe muslimanë, të cilët mbase deri diku e dijnë por nuk e kanë të qartë si duhet.

Njeriun e parë të cilin e krijoi All-llahu xh. sh. si dhe peygamberin e parë që e dërgoi, është Ademi a.s. Shpalljen që ia shpalli Ademit a.s. ua shpalli edhe të gjithë peygamberëve të tjerë prej te Ademi e gjer te peygamberi i fundit Muhamedi a.s., pra feja në të cilën thirri Ademi a.s. ishte Islami dhe në të njejtën fe thirrën të gjithë peygamberët tjerë.

قُولُوا آمَنَّا بِاللَّهِ وَمَا أُنزِلَ إِلَيْنَا وَمَا أُنزِلَ إِلَىٰ إِبْرَاهِيمَ وَإِسْمَاعِيلَ وَإِسْحَاقَ وَيَعْقُوبَ وَالْأَسْبَاطِ
وَمَا أُوْتِيَٰ مُوسَىٰ وَعِيسَىٰ وَمَا أُوتِيَ النَّبِيُّونَ مِن رَّبِّهِمْ لَا نُفَرِّقُ بَيْنَ أَحَدٍ مِّنْهُمْ وَنَحْنُ لَهُ مُسْلِمُونَ

“Ju (besimtarë) thuani. “Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbedhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre peygamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur.” (el-Bekare: 136).

وَجَاهِدُوا فِي اللَّهِ حَقَّ جِهَادِهِ هُوَ اجْتَبَاكُمْ وَمَا جَعَلَ عَلَيْكُمْ فِي الدِّينِ مِنْ حَرَجٍ مِّلَّةَ
أَبِيكُمْ إِبْرَاهِيمَ هُوَ سَمَّاكُمُ الْمُسْلِمِينَ مِن قَبْلُ وَفِي هَذَا لِيَكُونَ الرَّسُولُ شَهِيدًا عَلَيْكُمْ
وَتَكُونُوا شُهَدَاءَ عَلَى النَّاسِ فَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَاعْتَصِمُوا بِاللَّهِ هُوَ مَوْلَاكُمْ
فَنِعْمَ الْمَوْلَىٰ وَنِعْمَ النَّصِيرُ

“Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur’ani) ju quajti muslimanë, për të qenë i Dërguari dëshmitarë i juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbahuni me All-llahun se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtarë i madh që është.”

All-llahu xh.sh. nga Mëshira e Tij e pakufishme e njohtoi njeriun me parimet themelore të fesë, ashtu që ata të mos shetisin poshtë e lartë për të gjetur të vërtetën fetare. Me që burimi i fesë është një edhe pejgamberët kumtuan një fe – *Islamin*.

Ajo që është qenësore në të gjitha shpalljet, duke filluar prej të parës e gjer te e fundit, është dhe mbetet: **besimi në Një All-llah, besimi në ditën e Mbrëmë – Ahiretin, adhurimet, lutjet, namazi, dhënia e zeqatit në favor të bashkësisë dhe të varfërve.**

Nga shkaku i unitetit dhe i lidhshmërisë së ngusht mes shpalljeve, ithtarët e besimit Islam, rrespektivisht muslimanët e sodit pranojnë dhe vërtetojnë të gjitha shpalljet dhe të gjithë pejgamberët e mëparshëm duke qenë të bindur se të gjitha parimet themelore të fesë së vërtetë e shpallur prej All-llahut xh. sh. kurnjëherë nuk humbën vlerën e tyre e as që i ndryshuan. Këtyre parimeve iu përmbajtën të gjithë pejgamberët në vijim si dhe pejgamberi i fundit Muhamedi a.s. për këtë unitet, Kur’ani kerimi në shumë vende përkujton unitetin e përhershëm, në mes tjerash po përmendim këtë ajet:

شَرَعَ لَكُمْ مِنَ الدِّينِ مَا وَصَّىٰ بِهِ نُوحًا وَالَّذِي أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ وَمَا وَصَّيْنَا بِهِ إِبْرَاهِيمَ وَمُوسَىٰ وَعِيسَىٰ أَنْ أَقِيمُوا الدِّينَ وَلَا تَتَفَرَّقُوا فِيهِ كَبُرَ عَلَى الْمُشْرِكِينَ مَا تَدْعُوهُمْ إِلَيْهِ اللَّهُ يَجْتَبِي إِلَيْهِ مَنْ يَشَاءُ وَيَهْدِي إِلَيْهِ مَنْ يُنِيبُ

“Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhit dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. All-llahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon atë që i drejtohet Atij.” (esh-Sura:13).

Pejgamberët e përmendur në ajetet e larshënuara ndoshta janë edhe më të rëndësishmit sepse Nuhin dhe Ibrahimin për pejgamber i pranojnë të gjithë besimtarët monoteistë si: hebrenjtë, të krishterët dhe muslimanët. Nga ana tjetër, hebrenjtë, Musain e konsiderojnë si themelues të fesë hebraike; të krishterët Isain e konsiderojnë si themelues të krishterizmit, ndërsa muslimanër, duke mos bërë kurrfarë dallimi, i pranojnë dhe i njohin të gjithë pejgamberët për të dërguar të All-llahut xh. sh.

Përndryshe siç ka përjetuar njeriu fazët e zhvillimit shoqëror e politik, kuptohet se edhe shpallja ka përjetuar ndryshimet e veta me theks të veçnat në kuptimin legjislativ. Njeriu duke mos qenë gjithmonë në të njëjtin nivel të zhvillimit të tij në aspektin intelektual e mendor, All-llahu xh. sh. ashtu ua dërgonte shpalljen peygamberëve me qëllim që të përmbush kërkesat dhe nevojat e njeriut në kuptim të asaj që është e dobishte dhe duke e larguar nga ajo që është e dëmshme. Pra, ndryshimet i hasim vetëm në kuptimin e legjislacionit – shariatit, ndërkaq në kuptimin e besimit nuk ka pasur kurrfarë ndryshimesh dhe kjo nënkupton se gjashtë kushtet e imanit kanë kontinuitetin e tyre prej peygamberi të parë Ademit a.s. deri te peygamberi i fundit Muhamedi a.s. Kjo njëherit është edhe përgjigje për orientalistët dhe kundërshtarët e Islamit se kinse edhe feja Islame duhet të pësojë ndryshime pas sa e sa shekuj që ekziston?!

Lidhur me këtë Ebu Hanifeja thotë: *“Pamëdyshje se të gjithë peygamberët kumtuan një fe, në mes sheriave të tyre ka pasur ndryshime, mirëpo besimi ka qenë i njëjtë te të gjithë popujt – peygamberët e All-llahut xh. sh.”* Ebu Hanifeja si duket mendimin e tij e ka mbështetur në ajetin kur’anor:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ مُصَدِّقًا لِمَا بَيْنَ يَدَيْهِ مِنَ الْكِتَابِ وَمُهَيِّمًا عَلَيْهِ فَاحْكُم بَيْنَهُمْ بِمَا أَنْزَلَ اللَّهُ وَلَا تَتَّبِعْ أَهْوَاءَهُمْ عَمَّا جَاءَكَ مِنَ الْحَقِّ لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَاجًا وَلَوْ شَاءَ اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ

“Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur’anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshme dhe garantues i tyre. Gjyko, pra, mes tyre me atë që All-llahu e zbriti, e mos pëlqej epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që i erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligje program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte Alahu, do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovtojë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquuni për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu, e Ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshi.” (el-Maide: 48.)

Sheriati ose rregullat e fesë me të cilën përcaktohen marrëdhëniet ose mënyra e veprimeve kanë ndryshuar dhe kanë bërë një përparim të ngadalshëm, por

ndryshimi gjithnjë ka ardhur nëpërmjet Shpalljes Hyjnore, e kurrsesi nëpërmjet të një metamorfoze të ngadalshme e të pavetëdishme.

Veçoritë e Islamit

Feja Islame posedon shumë veçori të cilat e dallojnë nga fetë e tjera qiellore, ose më mirë të themi nga feja hebraike dhe ajo krishtere. Për mjete rast do të përmendim vetëm katër veçoritë më kryesore të Islamit e që janë:

1. Feja Islame është e shpallur nga All-llahu xh. sh.,
2. Ka përfshirë të gjithë nevojat e jjeriut,
3. Është shpallur për të gjithë kohërat, për të gjithë popujt dhe të gjithë vendet dhe
4. Ka paraparë shpërblime për njeriun në këtë botë dhe në botën tjetër.

1. Feja Islame është e shpallur nga All-llahu xh. sh.

Islami me tërë atë që përmban është Shpallje e All-llahut xh. sh. Brenda 23 vjetësh, pandërprerë iu shpall Pejgamberit s.a.v.s. Kur'an paraqet kuptimi dhe fjala e cila është e shkruar në të, ndërsa kuptimi nga All-llahu xh. sh. Kurse fjala e Pejgamberit a.s. paraqet sunnetin – hadithin e Muhamedit a.s. që është burimi i dytë i fesë Islame.

Sipas kësaj veçorie, Islami ndërron nga fetë tjera sepse të gjitha ato burojnë nga njeriu. Duke filluar prej fesë hebraike dhe fesë krishtere, të cilat konsiderohen si të shpallura sepse nismën e kanë nga Libri i Shpallur; Tivrati ose Inxhili, prandaj edhe quhen fe qiellore për dallim nga religjionet apo ideologjitë tjera që janë të menduara nga njeriu me të cilat ka mëtuar të përmbush kërkesat dhe dëshirat e veta.

Të flasim në hollësi për argumentet se Islami është i Shpallur nga All-llahu xh. sh., do të na shpienin shumë larg, andaj sa për ilustrim do të përmendim si më poshtë:

a) *Argumentet kur'anore*

Se Kur'ani është Shpallje e All-llahut xh. sh. Vërtetojnë shumë ajete kur'anore e ndër to:

إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ

“Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në natën e Kadrit.” (el-Kadër: 1).

وَإِنَّكَ لَتُلْقَى الْقُرْآنَ مِنْ لَدُنْ حَكِيمٍ عَلِيمٍ

“E s'ka dyshim se ti (Muhammed) e pranon Kur'anin nga i Urti, i Dijshmi.”

(en-Nemël. 6)

إِنَّا أَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الْكِتَابَ بِالْحَقِّ فَاعْبُدِ اللَّهَ مُخْلِصًا لَهُ الدِّينَ

“Ne ta shpallëm ty Librin për hir të së vërtetës, andaj ti adhuroje All-llahun duke qenë i sinqertë në adhurimin e Tij!” (ez-Zumer: 2.)

Kur'ani në tërësi përmbanë fenë Islame, andaj e kemi për detyrë që t'i përmbahemi vetëm atij, assesi librave të tjera të cilat konsiderohen si të shpallura ose librave të cilat njeriu i ka menduar, gjoja se, në to do të gjejë prehje dhe shpëtim.

b) *Argumente nga hadithit*

Në bazë të definicionit të hadithit – sunnetit, dimë se çdo fjalë, vepër, pëlqim i Pejgamberit a.s. në mënyrë indirekte paraqet Shpalljen e All-llahut xh. sh. andaj jemi të obliguar që të veprojmë sipas udhëzimeve të tij, e mbi të gjitha kur kemi parasyshë garancën e All-llahut xh. sh. për thëniet dhe veprat e Pejgamberit a.s. i Cili thotë:

وَمَا يَنْطِقُ عَنِ الْهَوَىٰ ﴿٣﴾ إِنْ هُوَ إِلَّا وَحْيٌ يُوحَىٰ ﴿٤﴾

“Ai nuk flet sipas qejfit të vet – Ajo (që flet ai) është vetëm Shpallja, që i ka ardhur atij.” (en-Nexhm. 3-4).

Ajetet kur'anore assesi nuk mundemi që t'ia përshtatim të arriturave shkencore, mirëpo, me që kundërshtarët nuk i pranojnë ajetet kur'anore për argument se Kur'ani është Shpallur nga All-llahu xh. sh., atëherë ne do të përmendim argumentet racionale dhe përmbajtësore të Kur'ani kerimit.

Kur'ani kerimi si mrekulli e përhershme në veti ngërthen dy aspektet e njohura:

1. Në kuptimin përmbajtësor dhe
2. Në kuptimin gjuhësor.

Studijuesit e Kur'anit në të kaluarën kanë arritur të binden se Kur'ani kerimi në veti përmbanë të gjitha shkencat, ose më mirë të themi se përmbanë elementet shkencore gati të të gjitha shkencave; nëse studiojmë një ajet kur'anor ku përmendet rrotullimi i Tokës, një ajet tjetër i cili përmend zhvillimin e fenomeneve natyrore, krijimin dhe formimin e relievit, ujërat e ëmbël dhe ujërat e njelmët, vet funksionimin e organeve të brendshme të trupit të njeriut etj. Do të përfundojmë se Muhamedi a.s. nuk ka mundur që as për s'afërmi t'i ketë mësuar e as t'i ketë ditur këto shkencë.

Në kuptimin gjuhësor, Kur'ani kerimi paraqet një libër të përkryer poetik i cili përfshinë të gjitha llojet e letërsisë. Gjuha e tij e pastër dhe letrare në gjuhën arabe ka bërë që bashkëkohanikët e Muhamedit a.s. si dhe divat e poetëve të sotëm nuk mund të përpilojnë një libër si Kur'ani. Gjuha arabe e Kur'anit ka bërë që kjo gjuhë të mos pësojë ndryshime prej kur ekziston e gjer më sot.

Pra, shikuar në këto dy aspekte, përfundojmë se Kur'ani nuk është vepër e njeriut, por është Shpallje e All-llahut xh. sh., ndërkaq fjalët e Muhamedit a.s. kanë qenë inspirim nga All-llahu xh. sh. dhe mu për këtë ato janë burimi i dytë i sheriatit.

2. Islami ka përfshirë të gjitha nevojat e njeriut

Kur kemi përmendur për definicionin e Islamit, mes tjerash kemi përmendur se ai përfshinë të gjitha nevojat jetësore të njeriut. Ndërsa fetë tjera kanë analizuar një çeshtje apo nevojë të njeriut kurse i kanë hyrë në borxh tjetrës. Njeriu është i tillë, ai nuk mund të dijë gjithçka çka i mungon njeriut, ose ndryshe thënë: atë që e sheh të mirë një njeri tjetri e sheh të keqe etj. Pra, këto do e kuptonim nëse analizojmë çdo lëndë fetare, që për rastin është e pamundur, do të kuptonim se çfarë domethënie ka ibadeti, sjellja në kuptim të raporteve që i ka vënduar All-llahu xh. sh. etj.

3. Islami është shpallur për të gjithë kohërat, për të gjithë popujt dhe për të gjithë vendet

Ndër veçoritë më kryesore dhe më të rëndësishme të fesë Islame është se sheriatet përmban nevojat e njeriut pavarësisht se ku jeton dhe se kur do të jetojë. Sheriatet e mëparshme nuk kanë qenë të këtij karakteri, përkundrazi ato i janë dedikuar një populli, një vendi dhe një kohe, kjo sepse edhe vetë pejgamberi i mëparshëm ka patur këtë karakter. Ndryshe nga ata, Muhamedi a.s. është i dërguari i fundit dhe për të gjitha kohërat dhe popujt.

وَمَا أَرْسَلْنَاكَ إِلَّا كَافَّةً لِّلنَّاسِ بَشِيرًا وَنَذِيرًا وَلَٰكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ

“Na të kemi dërguar ty për tërë njerëzimin – sihariques dhe paralajmërues, por shumica e njerëzve nuk dinë,” (Sebeë: 28).

قُلْ يَا أَيُّهَا النَّاسُ إِنِّي رَسُولُ اللَّهِ إِلَيْكُمْ جَمِيعًا الَّذِي لَهُ مُلْكُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ يُحْيِي وَيُمِيتُ فَأَمِنُوا بِاللَّهِ وَرَسُولِهِ النَّبِيِّ الْأُمِّيِّ الَّذِي يُؤْمِنُ بِاللَّهِ وَكَلِمَاتِهِ وَاتَّبِعُوهُ لَعَلَّكُمْ تَهْتَدُونَ

“Thuaj: “O njerëz, unë jam Pejgamber i All-Ilahut për të gjithë ju, i Atij që i përket pushteti mbi qiej dhe Tokë. Vetëm Ai është i vetmi Zot, jeta dhe vdekja janë vepra të Tij, – prandaj besoni në All-Ilahun dhe në të Dërguarin e Tij, lajmëtarin e fesë, i cili nuk di shkrim-lexim, i cili beson në All-Ilahun dhe fjalët e Tij; shkoni pas tij – për të qenë në rrugën e drejtë!” (el-A’raf: 158).

Se Islami është i tillë shumë mirë na dokumentojnë shekujt e kaluar prej kur All-Ilahu xh. sh. e shpalli këtë fe. Edhe pse, atë e shpalli në Gadishullin Arabik, ai për një kohë shumë të shkurtër përfshiu tërë botën.

Fenë Islame e pranuan popuj të ndryshëm nga vetëdëshira. Nëse pranojmë pretendimet e orientalistëve se feja Islame është përhapur me dhunë, të cilët nuk kanë kurrfarë argumentesh, atëherë pohimet e tyre s’janë gjë tjetër veçse shpifje! Popujt e tillë deklarojnë se prehjen dhe qetësinë shpirtërore e fizike e kanë gjetur në sheriatin Islam.

Ligjet të cilat i ka paraparë njeriu ndërojnë shumë shpejtë. Ky ishte si duket shkaku që në vitin 1958 të organizohet simpoziumi i juristëve botëror në Paris.

Tubimi kishte për qëllim që s'bashku të vendojnë ligjet ndërkombëtare të cilat, bile për një kohë të gjatë nuk do të pësonin ndryshime. Mes tejrash vëmendje e posaçme iu kushtu refetatit të një juristeje franceze e cila mes tjerash pat thënë: “Nëse dëshirojmë të vendojmë ligje të pandryshueshme për gjithmonë, duhet pa tjetër t'i kthehemi sheriatit Islam, pikërisht katër medhhebeve të sheriatit Islam.”

Se çfarë ligjesh ka parapa Islami, me të vërtetë do të na çonte shumë larg, por lexuesi me siguri do të ketë rastin që të lexojë më tepër nëpër shkenca të cilat janë të specializuara për këtë çështje.

4. Islami ka paraparë shpërblime për veprat e kryera në këtë botë dhe në botën tjetër

Sheriati Islam nuk përmban vetëm këshilla dhe udhëzime, por njëherit ka përcaktuar shpërblime dhe ndëshkime për veprat e kryera, në këtë botë dhe në botën tjetër – Ahiret. Pra, shpërblimet të cilat i ka përcaktuar Islami janë të lidhura ngusht me Ahiretin, pra për disa vepra ka përcaktuar shpërblime ose dënime edhe në këtë botë. Nisur nga kjo përfundojmë se diapazoni i shpërblimeve apo i ndëshkimeve në Islam është shumë i gjerë dhe përfshirës. Ato kanë të bëjnë me çështjet e besimit, të moralit, të ibadeteve, adhurimit, të raporteve në mes njëri-tjetrit, raporteve me natyrën etj.

Shpërblimet e shfrytëzuara në këtë botë, sipas Islamit, nuk pakësojnë shpërblimet e botës tjetër – Ahiretit, pra edhe shpërblimi i gjynahqarit në Ahiret do të jetë I mundshëm nëse ai pendohet bindshëm. Pendimi I bindshëm nga njeriu lyp që ai të largohet nga vepra e keqe përgjithmonë, përndryshe pendimin e rrejshëm All-llahu xh. sh. nuk e pranon.

Përveç këtyre veçorive kryesore të Islamit, ekzistojnë edhe shumë të tjera. Mirëpo, për shkaqe objektive, sidomos pasi që kjo është temë shumë e gjerë, kësaj radhe do të majftojmë me kaq.